

Misioni i Kosovës ndihmon komunitet të themelojnë dhe mirëmbajnë biblioteka ligjore

Refik Redenica, avokat nga Gjilani, viziton shpesh ndërtesën komunale. Ai shkon në zyrat e komunës jo për të polemizuar me avokatët apo për të intervistuar punëtorët, por për ta shfrytëzuar bibliotekën ligjore të hapur kohëve të fundit.

“Unë kam një zyre juridike,” thotë Radenica, “dhe mundësia për të pasur qasje në ligjet e fundit ma lehtëson shumë punën.” Duke dhënë një shembull, Radenica shpjegon se kohëve të fundit po ndërtohen shumë ndërtesa dhe se shumë klientë të tij kanë pyetje rreth asaj se si mund të mbrohen nga ndonjë parregullsi eventuale kur t’i nënshkruajnë kontratat apo blejnë apartamentet. “Është dallim shumë i madh nëse e bazoj këshillën time në ligjin e aplikueshëm gjatë bisedave me klientët e mi,” thotë ai.

Biblioteka ligjore në Gjilan është themeluar në janar të vitit 2009 si pjesë e një projekti të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Njëkohësisht OSBE ka filluar themelimin e bibliotekave ligjore në 24 komuna të Kosovës, me qëllim që t’u ofroj zyrtarëve komunal dhe publikut të gjerë një vend ku mund të kenë qasje në dokumente dhe literaturë ligjore.

Tetë muaj më vonë 20 biblioteka janë duke funksionuar në mënyrë të suksesshme., thotë Ida Manton nga Misioni i OSBE-së e cila e ka menaxhuar këtë projekt.

Shembuj të mirë

Manton shpjegon se OSBE ka filluar furnizimin e bibliotekave me libra dhe materiale juridike, si dhe me nga një fotokopjues/printer/skaner. “Por, gjëja më e rëndësishme për funksionimin e bibliotekave është interesimi, vullneti dhe kapaciteti i komunave për t’i pajisur ato me legjislacionin komunal dhe t’i bëj ato të dobishme për qëllime të brendshme, si dhe për qytetarët” thotë ajo dhe shton se komuna e Gjilanit është një shembull i mirë.

“Kur kemi filluar,” thotë Lulzim Rizahu, përgjegjës për bibliotekën e Gjilanit, “kemi sjellë literaturën tonë juridike për ta bërë bibliotekën funksionale që nga dita e parë. Me kalimin e kohës, kolegët tanë na kanë dhuruar materiale nga departamentet e tyre përkatëse dhe tani gjërat janë shumë më mirë.”

Sipas Hivzi Matoshit, shef i zyrës ligjore në komunën e Gjilanit, biblioteka tani përmban të gjitha urdhëresat dhe ligjet relevante të komunës. “Nëse ka ndonjë dilemë ose paqartësi rreth çështjeve juridike, njerëzit mund të vijnë në bibliotekë, ta konsultojnë ligjin përkatës dhe ta gjejnë informatën dhe shpjegimin e duhur.”

Manton vë në pah se edhe shumë biblioteka tjera po funksionojnë në mënyrë të suksesshme: “Shumë komuna po punojnë mirë, dhe secila po i adaptohet nevojave të

veta specifike. Biblioteka në Han të Elezit, për shembull, po bashkohet me departamentin e arkivës, dhe po bëjnë një punë shumë të mirë.”

Stimulim për më shumë rezultate

Për t’i stimuluar njerëzit që punojnë në biblioteka, OSBE ka organizuar dy trajnime, një për legjislacionin komunal dhe një tjetër për mbajtjen e shënimeve dhe arkivës. Një stimulim shtesë për ata të cilëve ndoshta ende iu mungon entuziazmi i Matoshit dhe Rizahut do të jetë gara për bibliotekën ligjore më të mirë, e cila do të mbahet kah fundi i vjeshtës.

Duke u përgatitur për këtë garë, Matoshi thotë se biblioteka e Gjilanit tashmë u ka dërguar një kërkesë për libra dhe material juridik shtesë disa organizatave vendore dhe ndërkombëtare. “Por, derisa presim përgjigjen e tyre, ne po punojmë për të përmirësuar inventarin me mundësitë tona,” shton ai.

Rizahun e inkurajon fakti se numri i njerëzve që e vizitojnë bibliotekën për t’i shfrytëzuar shërbimet e tyre është në rritje gjatë tre muajve të fundit. “Me sa duket, njerëzit kanë filluar të shohin dobinë që sjell konsultimi i dokumenteve ligjore, kështu që puna po ecën më mirë.”

Shërbime më të mira

Me të gjithë hapat e ndërmarrë deri më tani, është normale të pritët se shërbimet e ofruara nga bibliotekat për punëtorët e komunës dhe qytetarët do të vazhdojnë të përmirësohen. Manton thekson se banorët e çdo komune duhet të jenë në gjendje të kenë qasje në të gjithë dokumentet që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Biblioteka ligjore mund t’ua ofroj këtë qasje.

Duke shikuar këtë çështje nga një këndvështrim tjetër, Redenica shpreson për më shumë klientë ndërkohë që këshillat e tij juridike përmirësohen. “Sa më i suksesshëm që je në ofrimin e asaj për të cilën njerëzit kanë nevojë, aq më shumë klientë do të kesh,” përfundon ai.

Petrit Qarkagjiu dhe Nikola Gaon